



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 7206/2 Prot.

Lezhë, më 24. 06. 2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në datën 24.06.2025, në orën 10:00, në Qendrën Kulturore të Fëmijëve Lezhë, mbi dëgjuesën publike në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e hapjes së rrugës së lagjes Butem dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë T&J Construction shpk, për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë”.

Takimi u hap nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ndue Luli, i cili shprehu vlerësimin e tij për këtë gjë, që u shërben banorëve të asaj zone, si dhe tha që meqë kjo rrugë kalon në zonë pyjore, prandaj bëhet kjo dëgjuesë, për të dëgjuar specialistët, për të dëgjuar banorët, në mënyrë që më pas të kalojë në këshill për miratim.

Kryetari i dha fjalën përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve në Drejtorinë e Bujqësisë në bashki, z. Artan Palushi.

**-Artan Palushi:** Shumica me sa shoh kanë qenë pjesëmarrës edhe te dëgjuesja tjetër. Duhet të sqarojmë ato gjëra teknike dhe ligjore që na duhen për këtë rast. Siç u tha më para nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, kemi të bëjmë me një ndërtim rruge, për përmirësimin infrastrukturor të zonës. Ky projekt është i hartuar nga Bashkia Lezhë, i miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe i përcjellë në Këshillin e Qarkut me një shkresë të gushtit të vitit të kaluar, një kërkesë për financim, dhe në organin vendimmarrës të Këshillit të qarkut është miratuar ky investim, i cili do zbatohet nga një kompani e cila do pajiset pastaj me leje ndërtimi, do marrë pjesë të fondit pyjor në përdorim për një periudhë të caktuar siç e njeht ligji, dhe pikërisht ky diskutim ka të bëjë me sqarimin e pjesës që ai segment rrugor që do ndërtohet kalon nëpër fond pyjor në pronësi të bashkisë dhe një pjesë kalon nëpër sipërfaqe publike dhe private. Pra që të merret leja e ndërtimit, më së pari duhet të zgjidhet marrëdhënia juridike me pronësinë e tokës dhe për rastin tonë japim dakordësinë në këshillin bashkiak që rruga të ndërtohet në fondin pyjor dhe për pjesën e gjurmës ku kalon rruga, kompania do të paguajë një tarifë siç e ka parashikuar ligji, është një tarifë qeramarrje në këtë rast, për periudhën e caktuar që ka lidhje me grafikun e punimeve, që shkon afërsisht një vit bashkë me periudhën e garancisë. Kjo procedurë është tërësisht ligjore dhe mbështetet në ligjin për pyjet dhe VKM nr. 888, datë 27.12.2022 dhe thotë që për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimet në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre. Tani, në këtë rast, sipas këtij vendimi, konkretisht pika 15 që thotë

rastet e ndryshimit të kategorisë së territorit dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshim të kategorisë së territorit, dhe pikërisht pika 15 qartëson, përjashtohen nga kjo procedurë projektet e ndërtimit të infrastrukturave lineare si rrugë, linja të transmetimit ajror apo nëntokësore të energjisë elektrike, tubacionet apo kanalet e devijacionit për HEC-e, panele diellore, impiante eolike, fotovoltaike, të naftës, të gazit, të telekomunikacionit si dhe teleferikët të cilët në përputhje me projektet e miratuara, kërkojnë për çdo trase të pastruar nga vegjetacioni, me gjerësi më të vogël se 10 metra. Në këtë rast, duke qenë se ky objekt është me gjerësi më të vogël se 4 metra, nuk kemi të bëjmë me ndryshim kategorie. Pra, rruga do miratohet në këshilloin bashkiak si një vepër publike, do kalojë nëpër pyll, do i shërbejë komunitetit dhe sipërfaqeve pyjore aty, pra nuk ndryshohet. Gjurma e rrugës pas ndërtimit do hidhet në hartë dhe do mbetet si gjurmë rruge e përjetshme. Është parashikuar rehabilitimi mjedisor, raporti është 1 me 3 dhe këtë do ta bëjë vetë bashkia, duke pyllëzuar dy anët e rrugës, me qëllim që të stabilizohet segmenti i rrugës, që mos të kemi problem me erozionin, me rrëshqitjet, me fenomene të tjera mjedisore.

Kush ka ndonjë pyetje?

**-Ndue Luli:** Kush e do fjalën për pyetje, diskutime?

**-Preng Pjetri, banor:** Nuk ka pyll më prodhues kund. Ia bëj unë shërbimin. Vetëm të bëhet.

**-Artan Palushi:** Unë përmenda detyrimet ligjore. Pastaj iniciativat qytetare ne i mirëpresim.

**-Gjin Kola, banor:** Pyjet janë krejt të shtetit. 90% e rrugës është rrugë këmbësore. Mbetet vetëm me ju falenderu.

**-Ndue Luli:** Nqs nuk ka mendit tjetër, unë do them vetëm kaq. Është gjë shumë pozitive që lagjet e fshatrave tona bëhen me rrugë makine, që ato fshatra të rigjallërohen. Kam besim që këshilli bashkiak nuk do ta kundërshtojë fare, duke pasë parasysh mendimet tuaja dhe duke pasë parasysh dhe ato që na tha nga ana teknike inxhinieri.

**-Pjeter Tushaj, anëtar KB Lezhë:** Unë jam shumë i kënaqur se kemi marrë pjesë edhe herë të tjera në dëgjesa publike e nuk ka ardhë njeri dhe flasin mbrapa, por këta banorë e kanë vlerësuar dhe kanë ardhur.

**-Ndue Luli:** Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen.

SEKRETARI

Florinda Gungj  
8

KRYETARI

